



Raport vjetor 2022

QENDRA RINORE ARDHMËRIA – KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2022

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2022

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmëria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2022.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmëria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

2. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET

3. PROJEKTET


4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

1.1 SHETITJE NJË DITORE NË BOGË

Filluam vitin 2022 me aktivitetin e parë duke realizuar shetitjen një ditore në Bogë, grupi i vullnetareve kaluan një ditë shumë të mirë në bjeshkët e Rugoves duke shijuar skijimin dhe rreshqitjen në borë. Ishte një ditë relaksuese dhe socializimi në mes të rinjve si dhe aktivitet motivues për aktivitetet vullnetare të vitit 2022.

Zhvilluar me 11 Janar 2022



1.2 DITA E PAVARËSISË SË KOSOVËS

"17 Shkurti" Dita e Pavarësisë së Kosovës" Të rinjtë vendosen që të organizojn një anketë më qytetare që kishtë për qëllim mbledhjen e statistikave se sa kanë njohuri qytetarët e vendit tonë lidhje me shpalljen e Pavarësisë. Të rinjtë kanë krijuar një platforme digjitale në mënyrë që të kenë mundësi në një periudhë dy javore që të marrim përgjigjet nga hulumtimi në teren.. Çdo përgjigje ishte anonime dhe ka shërbyer si pasqyrë e njohurive qytetare. Një numer I madh I qytetereve është përgjigjur në menyre positive iniciatives tone dhe kemi gjetur informata që jane publikuar në një video digjitale.

Zhvilluar me 17 Janar 2022

1.3 SESION INFORMUES

Qendra Rinore ka realizuar një sesion informativ rreth mundësive të të rinjve për edukim në Amerikë dhe gjëgjësisht për aplikim në Universitete dhe kolegje të ndryshme Amerikane.

Sesioni informativ është realizuar në bashkëpunim me Advising American Center.

Në sesion moren pjesë të rinjë të moshës 15-17 vjeç që kanë synim studimet në Amerikë.

Zhvilluar me 3 Mars 2022



1.4 **RËNDESIDIA E UJIT**

Në Qender Rinore është zhvilluar një ëorkshop edukativ për për të rinjë të moshave të reja, Antaret e grupit rinor Vullnetar janë angazhuar për një kohe që të përgadisnin materialin punues dhe të organizohen për një paraqitje dinjtoze para grupit të moshes me te re. Në ëorkshop moren pjesë të rinjtë e dy shkollave fillore të qytetit të Klinës shënuan ditën botërore të ujit dhe aktivizimin e të rinjeve në ruajtjen dhe shfrytëzimin efikas të ujit.

Gjithashtu Vullnetaret promovuan ëorkshopin edukativ dhe përvojën e organizimit të iniciativës rinore në Radio alba <https://fb.ëatch/bVLMabrYU/> Në studio moren pjesë vullnetaret:, Blina Gashi dhe Rinor Berisha.

Zhvilluar me 22 Mars



1.5 **GLOBAL YOUTH SERVICE DAY**

Dita globale e shërbimit të të rinjve- grupi i të rinjve” Klina youth chapter” vizituan natyren dhe paisazhin që ka qyteti I Klinës, dhe mbledhen disa fotografi për të promovuar peizazhin dhe biodiversitetin e Klinës. Me këto informata dhe fotografi punuan një video dhe e paraqiten para publikut në linkun e youtube: <https://www.youtube.com/watchchannel>.

1.6 **AKTIVITET I BAMIRËSISË**

Qendra Rinore organizon aktivitete bamirësie, dhe gjithashtu edhe me rastin e festës së Fiter Bajramit vazhdoi Iniciativa rinore për të ndihmuar dhe përkrahur tri nga familjet me kushte të rënda ekonomike të Komunës së Klinës (Sferkë, Siqevë dhe Qupevë e poshtme).

Grupi i të rinjve Klina Youth Chapter, ka siguruar mjete financiare nga Bizneset private dhe Qytetaret bamirës dhe kontribuan në aktivitetin humanitar për festën e Bajramit.

Zhvilluar me xxx

1.7 **DITA BOTËRORE E LUFTËS KUNDËE DUHANIT**

Vullnetaret e organizates janë angazhuar dhe kanë organizuar puntori edukative kunder duhanit. Duhani si dukuri negative shumë e pranishme tek të rinjtë, dhe gjëgjësisht tek moshë shumë e re. Aktiviteti ynë kishte për qëllim që të ngrisim vetëdijën për pasojat që shkakton duhani si dukuri negative.

Në këtë puntori moren pjesë të rinjtë e moshës 12-14 vjeç nga qyteti i Klinës.

Zhvilluar me



1.8 **FESTA 1 QERSHORIT-DITA E FËMIJËVE**

Dita e Fëmijëve shënohet me 1 qershor në mbarë botën. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë, që në këtë ditë të ndihen të lumtur dhe të festojnë me prindërit dhe bashkëmoshatarët e tyre. Edhe në qytetin tonë të Klinës Vullnetarët e Qendres Rinore Ardhmeria shënuan ditën e 1 Qershorit me shumë lojëra kreative për fëmijë në parkun e qytetit “Ilir Merturi”.

Me 1 Qershor fëmijët kanë ditën e tyre të festës, dhe të rinjtë zhvilluan aktivitetet e larmishme për ta bërë këtë ditë sa më të bukur për të vegjlit. Në këtë aktivitet moren pjesë një numër i madh fëmijësh, ku shihej një gezim dhe një buzëqeshje në fytyrat e secilit fëmijë. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me mësuesen Fitnete Abazi dhe nxënësit e saj për pjesëmarrje në lojëra, si dhe të gjithë prindërit e fëmijëve.

Zhvilluar me 1 Qershor 2022.



1.9 **PREZANTIM-PROMOVIM**

Prezantimi dinjitoz në konferencën regionale të Pejës, nga vullnetari Rinor Berisha për mobilizimin e vullnetareve për të zhvilluar Intervista dhe shpërndarë broshura vetëdijësuese për parandalimin e Korrupsionit në Komunën e Klinës. Mobilizimi i vullnetareve është mundësuar nga projekti “Fuqizimi i lidhjeve në mes të shoqërisë civile dhe Institucioneve Publike për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë” që zhvillohet nga ojq [HUMAN - Organization for Community Development, Kosova](#)



1.10 **PROGRAMI VEROR 2022**

Programi veror është zhvilluar nga 12-23 Korriku dhe ka zgjatur dy javë me aktivitete për fëmijë. Programi ka pasur për qëllim zhvillimin e të rinjve për të udhëhequr dhe zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet e të rinjve për të punuar me fëmijë.

Programi është zhvilluar çdo ditë dhe në secilin ditë kanë qenë të angazhuar shumë vullnetar për të realizuar aktivitetet me fëmijë. Aktivitetet kanë filluar me lojëra dhe aktivitete edukuese për moshën 6-10 vjeq. Gjithashtu në kuadër të programit janë zhvilluar Animacione, workshope dhe lojëra në natyrë.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve është përdorur metoda edukimit jo-formal dhe puna e ekipore kreative për të edukuar fëmijët si dhe të njëjten kohë të zhvillojnë lojëra dhe të arctohen njëkohësisht. Për të përfunduar të gjithë programin, kemi reflektuar në të gjitha aktivitetet e zhvilluara, gjithashtu është zbuluar shoku sekret i cili gjatë gjithë programit secili pjesëmarrës u mbështet nga shoku sekret, me dhurata dhe mesazhe, për të ndjekur procesin e të mësuarit dhe shoqërizimin e secilit pjesëmarrës.



Vullnetarët organizuan një koktej për fëmijët dhe gjithashtu lojë dhe vallëzim për grupin. Të gjithë të rinjtë kanë kaluar një kohë të mrekullueshme gjatë programit veror.



Zhvilluar prej 12-23 Korrik 2022

1.10 TRYEZË E RRUMBULLAKTE-NGACIMIMET SEKSUALE TEK TË MITURIT

Në kuadër të projektit: Fuqizimi i lidhjeve në mes të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Publike për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë është organizuar një Tryezë e Rrumbullakët me temën: "Dukuria shqetësuese e dhunes dhe ngacmimeve seksuale tek te miturit"

Kjo Tryezë është realizuar në Qënder Rinore , e organizuar në bashkëpunim me organizatën [HUMAN - Organization for Community Development, Kosova](#) nga Peja.



Zhvilluar me 19 Shtator 2022, në Klinë

1.10 DEBAT NË RADIO

Debat për Të drejtat e të rinjëve dhe pjesëmarrja në vendimmarrje! Kjo temë është trajtuar me: znj. Fatjona Gashi – drejtoreshë e Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport në Klinë, znj. Vitore Zefi - menaxhere e Qendres rinore "Ardhëria" në Klinë dhe znj. Elsa Zenunaj – nënkryetare e Këshillit të nxënësve të Gjimnazit "Luigj Gurakuqi" në Klinë.

Mendimet e tyre për këtë temë i kanë dhënë edhe të rinjtë nga qyteti i Klinës dhe fshatrat Zllakuqan dhe Gremnik.

Zhvilluar me 20 shtator 2022

1.10 JAVA E RINISË NË KLINË

Nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Klinë, është realizuar edhe "Java e Rinisë 2022". Trajnimet janë zhvilluar në [Qendra Rinore Ardhmëria Klinë](#) dhe kemi realizuar ditën e parë të trajnimit për të njoftuar të rinjtë për "Ligjin për pjesëmarrje dhe Fuqizim të rinisë" dhe rëndësinë e përkrahjes së të rinjëve nga Insitucionet qeveritare.

Ndërsa trajnimin me temë: VULLNETARIZMI. Trajnimi mbajtur synoi njoftimin e të rinjëve mbi punën e Vullnetarizimit në nivele kombëtare dhe ndërkombetare, dhe mundësitë të shumta dhe të mundshme përmes punës dhe praktikave të vullnetarizmit, Trajnim i cili u mbështet nga Drejtorja për Rini Kulturë dhe Sport-Klinë, dhe u organizua dhe implementua nga Qendra Rinore "Ardhmeria" Klinë.

Trajnimi mbi temën e Vullnetarizimit përfshiu 21 të rinjë të komunës Klinës i cili edhe përmbylli aktivitetet e mbajtura për javën e Rinisë në Klinë.

Zhvilluar me 21& 22 Tetor 2022



1.10 LOJË SHPËRBLYESE PËR HALLOWEEN

Grupi i punës u lehtësua nga vullnetarët e Qendrës Ardhmëria dhe kështu kaloi një ditë plotë punë, argëtim dhe entuziazëm. Procesi i punëtorisë dhe punimeve të bëra sjelli lojën shpërblyese për të gjithë pjesëmarrësit e aktivitetit. Ëorkshopi edukativ ka përfshirë një numër të rinjëve të cilët punuan dhe dekoruan kungujt për festën HALLOWEEN 🍂.

Kungujt janë punuar nga të rinjtë që moren pjesë në Workshopin edukativo-kulturorë 🍂 dhe ato punime që u pelqyen (👍) në rrjetet sociale u shpërblyen nga organizatorët.

Zhvilluar me 31 Tetor 2022



1.10 20 NËNTORI-DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

20 Nëntor-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve kudo, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj tyre, si dhe të inkurajojë mirëkuptimin ndërmjet fëmijëve në gjithë botën. Për të shënuar këtë ditë të veqante kemi organizuar punëtori edukative për fëmijë në menyrë që të shprehën lirshëm për të thënë të drejtat e tyre dhe të kalojnë një ditë kreative së bashku me Vullnetarët e organizatës.

Aktiviteti është mundësuar nga të rinjtë në bashkëpunim me shkollën fillore “Motrat Qiriaz” si dhe në kordinim me mësuesit e klases së V’të.




20 Nëntor
2022

1.3 FESTA E 28 NËNTORIT

Për nder të festës së flamurit kombëtar, të rinjtë e organizates kanë organizuar një Kuiz diturie. Në këtë aktivitet edukativ-kulturor moren pjesë 25 nxënës të klasës së VI-të, pjesëmarrës nga dy shkollat fillore të qytetit të Klinës.

Falenderojm të gjithë bashkëpunoret, shkollat fillore dhe vullnetaret për angazhim dhe kontribut në iniciativat rinore.

Zhvilluar me 28 Nëntor 2022



1.3 DITA NDËRKOMBËTARE E HIV/AIDS

Me 1 Dhjetor, shenuam ditën ndërkombetare të Hiv/Aids me një trajnim vetëdijësues për të rinjtë e moshave të reja. Ky trajnim është udhëhequr nga tri vullnetare të cilat sot për herë të parë kishin mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre për udhëheqjen e një trajnimi edukativ, gjithashtu pjesëmarrësit ishin shumë të interesuar dhe aktiv për temën e HIV/AIDS.

Falenderojm të rinjtë për bashkëpunim, si dhe mesueset e dy shkollave fillore për angazhimin e tyre në edukimin e të rinjve.

Zhvilluar me 1 Dhjetor 2022



1.3 NDIHMAT HUMANITARE

Vullnetar të pa lodhshëm dhe me vullnet mirë në këtë Dhjetor në Klinë. Puna vullnetare në Qendrën Rinore Ardhmeria solli një punë intensive të gjithë vullnetarëve aktiv gjatë muajit dhjetor 2022, në përgatitjen dhe dekorimin e kartolinave për urime të festive të fund vitit. Pas përgatitjes së kartolinave vullnetarët u angazhuan në përgatitjen e bankove në shesh kryesorë të Klinës. Shitja e këtyre materialeve, fondet e të cilave ishin të destinuara për blerjen e pakove për familje. Duke bërë kështu u sigurua një fond simbolik i cili u shpenzua për blerjen e artikujve dhe mbushjen e pakove me dhurata për familje. Andaj, si përfundim, vullnetarët e vet organizuar dhe të mbështetur nga "Qendra Rinore Ardhmeria" shkuan derë me derë për tu uruar familjeve në nevojë festat e fund vitit me nga



një pako dhuratë me gjëra ushqimore dhe higjienike të cilat u dhuruan nga Babadimri. Përmes këtij Aktiviteti, "Qendra Rinore Ardhmeria" u angazhua të përgatis të ri me vlera humane dhe ngritje të ndjenjes për punë vullnetare për tu shërbyer të tjerëve në nevojë. Falenderim i veçant shkron për të gjithë qytetarët e Klinës që kontribuan në blerjen e kartolinave dhe mundësuan blerjen e pakove për familje në nevojë. Falenderim për punën e pa lodhshme dhe me plote vullnet të vullnetarëve që gjatë kësaj kohe të ftoft punuan pa ndal dhe arriten qëllimin me kreativitetin e tyre dhe me plot pozitivitet që sollën në qytet. Vullnetaret: Alketa Gashi, Floresita Berisha, Rinor Berisha, Gresa Agushi Blendi Berisha, Rilind Gashi, Sadik Zenunaj, Rrezarta Berisha, Ermira Gashi, Dorela Kamberi.

Zhvilluar me 20 Dhjetor 2022



1.20 CHRISTMAS PARTY

Me eventin tonë final 🎉 Christmas party 🎉 përfundam vitin 2022.

Vullnetaret kaluan një mbrëmje festive dhe shumë argëtuese, ku gjithashtu kanë reflektuar të gjitha aktivitetet e organizuara gjatë tërë vitit 2022.

Vullnetaret janë Certifikuar për punën vullnetare gjatë tërë vitit 2022, gjithashtu ekipi i organizates është shumë mirënjohës për të gjithë ata që kontribuan në zhvillimin e aktiviteteve rinore në Klinë.

Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e ri 2023 🎄🎁🎉



2. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

2.1 PARTNERSHIP-FEBASI, KATANIA SICILI - SHAKE YOUR SOUND

Grupi I te rinjeve (8 te rinje) të Qendrës Rinore “Ardhmëria” morën pjesë në projektin Erasmus +, organizuar nga Febasi në Katania, Siçili. Shkëmbimi i të rinjve u mbajt nga 10 deri më 17 korrik duke mbledhur 40 pjesëmarrës nga Finlanda, Portugalia, Kosova, Polonia dhe Italia. Kjo javë e projektit pati një ndikim pozitiv tek vullnetarët tanë, ku ata mësuan se si të komunikojnë dhe të pranojnë kultura të tjera. U hapi një vizion te ri. Të gjitha vendet organizuan punëtori dhe mbremje ndërkulturore në të cilat ne mësuan shumë dhe u argëtuam shumë! Ne gjithashtu u mësuan të tjerëve gjëra për vendin tonë Kosovën, traditat tona, prejardhjen tonë dhe trashëgiminë kulturore!

Gjatë kësaj jave patëm mundësinë të vlerësonim dhe të merrnim pjesë të rëndësishme të secilit pjesëmarrës që mori pjesë atje! Përzierjmë punën me argëtimin dhe argëtimin me punën. Kishim mjaftueshëm kohë të lirë për t'u njohur dhe për të marrë pjesë të rëndësishme nga secili prej nesh. Çdo ditë ishte caktuar për çdo vend dhe kjo ishte pjesa më e mirë sepse ne mësuan gjëra të ndryshme çdo ditë dhe ishim të mahnitur nga informacionet që merrnim çdo ditë! Muzika ka qenë gjithmonë e pranishme dhe për këtë arsye ky projekt u quajt “Shake Your Sound”! Kjo përvojë do të jetë gjithmonë në zemrat e pjesëmarrësve tanë, sepse ata u reflektuan në një mënyrë kaq pozitive pas përfundimit të projektit!




Zhvilluar prej Korrik 2022

2.2 PEOPLE TO PEOPLE INTERNATIONAL

Dy të rinjë nga Grupi rinor “Klina Youth Chapter” moren pjesë në Konferencën Boterore PTPI 2022 që u zhvillua në Maqedoninë e Veriut, me njerëz të mëdhenj nga Zvicra, Suedia, Kosova, Danimarka, Gjermania, MB, SHBA, Rumania, Bullgaria dhe Armenia. Dy vullnetare si Blinera Gashi dhe Blina Gashi për here te pare përfaqësuan Kosovën dhe prezantuan aktivitetet e grupit jo-formal.

Konferenca zgjati 5 ditë, 21-26 Qershor 2022 në Shkup.



2.3 PARTNERSHIP –PALS-GERMANY-ESC.

Organizata partnere nga Gjermania ka përzgjedhur një vullnetare nga Rahoveci (Edisona Franca) për të punuar si vullnetare e solidaritetit evropian ne Stayberg në periudhë 12 mujore. Qendra Rinore Ardhmëria është organizata derguese dhe projekti ka filluar në Tetor 2022 dhe do të përfundoj në fund të Shtatorit 2023. Projekti është financuar nga Erasmus+ me qëllim që të zhvillohen aftësitë rinore dhe për të shkëmbyer kultura të ndryshme.

Shtator 2022

2.4 PARTNERSHIP – HUMAN

Në projektin “Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet OSHC-ve dhe Institucioneve publike në promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë” QRAK është partnere lokale dhe ka përgjegjësi për mobilizimin e vullnetarëve dhe vizitën e familjeve derë më derë, bisedën me familjarët dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve, duke rritur në këtë mënyrë ndërgjegjësimin e qytetarëve në zonat rurale për antikorrupsionin, sundimin e ligjit, etikën në qeveri dhe publik. arsimimi.

Zhvilluar prej Janar- Dhjetor 2022.

2.5 BASHKEPUNIM – KORPUSI I PAQES.

Organizata amerikane Korpusi i paqes ka sjellur tek ne një vullnetar, për të punuar si vullnetar e korpusit të paqes në Klinikë në periudhë prej 24 muajve. Aktiviteti ka filluar në Nëntor 2022 . Vullnetari do të punoj në menaxhmentin e Qendres Rinore dhe do të mbeshtes ekipin punues të projekteve.

Zhvilluar në Nëntor 2022.

3. PROJEKTET

3.1 RINIA AKTIVE NË KLINË

Projekti ” Projekti-Rinia aktive në Klinikë” , është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinikë me përkrahjen e Subvencionit të Komunës së Klinikës dhe gjëgjësisht Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve: Ligjerata për vetëdijësim dhe parandalimin e sëmundjeve infektuese , Ligjerata për vetëdijësimin e higjenes personale, Workshop për zhvillim të aftësive të buta Fushatë motivuese për iniciativat rinore në komunitet.

Implementuar Korrik-Dhjetor 2022.

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT





TABLE 3: PËRFITUESIT NË BAZË TË MOSHES

Period	<15	15-18	19-21	22-24	>24	Total

1/1/2022-31/12/2022	180	42	4	3	0	229
%	78.60	18.34	1.75	1.31	0.00	100.00

Period	Mashkull	Femer	Total
1/1/2022-31/12/2022	118	111	229
%	51.53	48.47	100.00

